



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261210
Datë: 21.02.2025
Numri i dokumentit: 06881197

C-IV-14-6739

Ankuesi:

R J nga fshati K, Komuna e Vitisë.

Kundër:

E paditura:

N.SH “NBI Agromorava”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me datë 12 shkurt 2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHEN** vendimet e Autoritetit të Likuidimit me nr.GJI035-0134 i datës 01 tetor 2014, nr.GJI035-0135 i datës 03 tetor 2014 dhe vendimi me nr.GJI035-0136 i datës 03 tetor 2014 si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

2.Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 27 tetor 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr.GJI035-0134 i datës 01 tetor 2014, me të cilin i është refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,400.00 euro, ndaj vendimit me nr.GJI035-0135 i datës 03 tetor 2014 me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e tre pagave në shumë prej 600.00 euro dhe vendimi me nr.GJI035-0136 i datës 03 tetor 2014 me të cilin i janë refuzuar kërkesa për kompensim për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 1,460.00 euro, për periudhën 01 janar 2004 deri më 01 dhjetor 2010 nga NSH “Agromorava” (në likuidim). Ankuesi në ankesë ka deklaruar se ankesën e paraqet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së

drejtës materiale dhe procedurale. Duke shtuar se i njëjti brenda afatit ligjor ka paraqitur kërkesat pranë AKP-së dhe se vendimet e marra nga ana e AKP-së janë pa kurrfarë baze ligjore andaj edhe kërkon që të njëjtat kërkesa të aprovohen nga ana e gjykatës. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur: Kopjet e vendimeve të kundërshtuara, Njoftimin për likuidim të ndërmarrjes i datës 17 korrik 2014, kopjen e letërnjoftimit, Specifikacionin mbi obligimet e pa paguara, Njoftimin e përgjithshëm për ndërprerjen e marrdhënjes së punës i datës 25 nëntor 2005.

Me datë 20 dhjetor 2023, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit duke shtuar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimeve të AL. Parashtruesi nuk ka theksuar se cilin nen e ka shkelur AL në marrjen e vendimeve e rrjedhimisht vendimet nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se ankesa është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Andaj ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Më datë 01 shkurt 2024, gjykata ka lëshar urdhër me të cilin ka kërkuar nga ankuesi që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit në gjykatë të deponoj provat në mbështetje të ankesës dhe atë: Kopjen e njoftimit lidhur me ndërprerjen e marrdhënjes së punës me emër të ankuesit, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës së pagave që NSH-ja i ka mbetur borxh si dhe prova të tjera shtesë.

Ankuesi të njëjtin urdhër e ka pranuar me datë 22 maj 2024, gjë që vërtetohet nga fletkthesa për dorëzim personal e cila gjindet në shkresa të lëndës, mirëpo urdhrin të gjykatës nuk i është përgjigj.

Gjykata me rastin e dërgimit të urdhrin e ka njoftuar ankuesin se nëse i njëjti nuk e përmbush urdhërin në afat prej 7 ditësh pas pranimit të të njëjtit, gjykata do t'ia refuzoj ankesën.

Me 20 dhjetor 2023, e paditura AKP ka parashtruar përgjigjen në ankesë me të cilën thekson se Agjencia si përfaqësuese ligjore e të paditurës i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në padinë e tij duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet. Më tutje në përgjigjen e AKP-së theksohet se “ në bazë të dispozitave të mësipërme, kërkesa duhet të jetë e paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSH-ja pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. AL-ja nuk ka donjë provë që parashtruesi ka dorëzuar ndonjë kërkesë për kompensim të pagave të pa paguara në gjykatë apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda afatit tre vjeçar si më lartë. Andaj si përfundim AKP thekson se ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që të dëshmojë se i takon kompensimi për ndërprerje të parakohshme të marrdhënjes së punës në shumë prej 1,400.00 euro, kompensimi për tri paga në shumë prej 600.00 euro si dhe kompensimi për paga të pa paguara në shumë prej 1,460.00 euro për periudhën 01 janar 2004 deri më datë 01 dhjetor 2010. Ankuesi së bashku me ankesën ka dorëzuar: Kopjet e vendimeve të kundërshtuara, Njoftimin për likuidim të ndërmarrjes i datës 17 korrik 2014, Kopjen e letërnjoftimit, Specifikacionin mbi obligimet e pa paguara, Njoftimin e përgjithshëm për ndërprerjen e marrdhënjes së punës i datës 25 nëntor 2005.

Gjykata gjeti se ankuesi dështoj që të dorëzonte prova në mbështetje të pretendimeve ankimore edhe pse gjykata lëshoi urdhër për deponimin e provave dhe paralajmërimin për mos paraqitjen e të njëjtave, andaj gjykata në mungesë të provave materiale me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet e ankuesit mori vendim mbi refuzimin e ankesës së ankuesit ashtu si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore me datë 08 nëntor 2023.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala